



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:117147
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05506427

C.nr.731/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen kontestimore të paditëses H.B nga M, të cilën e përfaqëson V.I av në M, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Baza e kontesti: Kompensim Dëmi, pas arritje se parashtresës mbi tërheqjen e padisë, jashtë seancës gjyqësore me datën 26.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditëses H.B nga M, e parashtruar në këtë gjykatë me dt.16.05.2023 kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Baza e kontesti: Kompensim Dëmi, **KONSTATOHET E TËRHEQUR.**

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja përmes te autorizuarit te saj i ka ushtruar padi me datën 16.05.2023, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Baza e kontesti: Kompensim Dëmi.

Me datën 26.03.2024 pranë kësaj gjykate përfaqësuesi i paditëses ka dorzuar parashtresën me te cilën ka deklaruar se e tërheq padinë e ushtruar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.731/2023 lidhur me kompensimin e dëmit, pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitat e nenit 261 par 3, të LPK-së, i cili nen parasheh se “Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia”, e në rastin konkret konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditëses H.B nga M, të cilën e përfaqëson V.I av në M, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Baza e kontesti: Kompensim Dëmi të **KONSTATOHET E TËRHEQUR.**

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 261 par.3 dhe 4, e në lidhje me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.731/2023 dt.26.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë në bazë të nenit 261.4 të LPK-së.